



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

11 qershor 2017

PERIUDHA E SHËRBIMIT TË VOTUESVE

Fillon më **20 maj** dhe përfundon më **28 maj 2017**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës është duke bërë përgatitjet për organizimin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen **më 11 qershor 2017**.

Votuesit do të kenë mundësi të informohen dhe t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në lidhje me Qendrën e tyre të Votimit në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e tyre, ose në ueb-faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org

Qytetarët mund t'i drejtohen Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, i cili do t'u ofrojë përgjigje në pyetjet si:

- **A kam të drejtë të votoj?**

Ju keni të drejtë të votoni nëse jeni të regjistruar në **Regjistrin Civil** dhe jeni nga mosha **18-vjeçare** në ditën e votimit më **11 qershor 2017**.

- **Ku duhet të votoj?**

Vizitoni Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj, ose ueb-faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org për t'u informuar se në cilën Qendër të Votimit ju mund të votoni.

- **Si ta ndryshoj Qendrën e Votimit?**

Për të ndryshuar Qendrën e Votimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mundëson ndryshimin e qendrës së votimit përmes aplikacionit online, që është vendosur në ueb faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org ku në anën e djathtë klikoni në linkun "Ku do të votosh?".

Aplikacioni online ju mundëson informacione se në cilën Qendër të Votimit jeni caktuar të votoni dhe gjithashtu ju mundëson ndërrimin e qendrës së votimit.

Ndërrimin e Qendrës së Votimit mund ta bëni edhe në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve duke plotësuar formularin për ndërrim të Qendrës së Votimit.